



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1039/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit "KAJMAK" Sh.p.k, me NUI: 810596679, me seli në Lubizhdë – Prizren, kundër debitorit "THE NORTH UNICORN" L.L.C, me NUI: 810112186, me seli në Zonën Industriale - Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Av. A.K. dhe Av. G.VB nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.721/21 të datës 22.09.2021 të Përmbartuesit Privat Bardh B. Tasholli me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datën 27.07.2023 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "THE NORTH UNICORN" L.L.C, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.721/21 i datës 22.09.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Bardh B. Tasholli dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.721/21 të datës 22.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme - faturave dhe kartelës financiare ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 30,569.83 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se propozimit nuk i janë bashkangjitur faturat mirëpo vetëm kartela financiare e cila nuk e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm në procedurë përmbartimore. Andaj i propozon Gjykatës ta aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit si të bazuar, të shfuqizohet Urdhri Përmbartimor P.nr.721/21 i datës 22.09.2021, të obligohet pala që t'ia paguaj shpenzimet përmbartimore përfshirë edhe shpërblimin e avokatit për përpilimin prapësimi.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se propozimi është i mbështetur në dispozita ligjore, dokumenti është i besueshëm dhe është i përshtatshëm për ekzekutim. Tutje thekson se prapësimi nuk është i bazuar në nenin 71 të LPP-së dhe qëllimi i debitorit është vetëm prolongimi i procedurës përmbarimore. Duke u bazuar në të lartcekurat i propozon Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pathemeltë si dhe ta vërtetoj Urdhrin Përmbarimor P.nr.721/21 i datës 22.09.2021.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret në faturat e bashkangjitura në propozim për përmbarim, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm,

për faktin se në rastin konkret faturat objekt i përmbartimit janë kopje, në shkresat e lëndës nuk është dorëzuar origjinali apo të vërtetuara tek organi kompetent.

Gjykata konstaton se faturat që gjenden në shkresat e lëndës nuk janë origjinale apo të vërtetuara tek organi kompetent, siç përcaktohet në dispozitën e nenit 37 të LPP-së, dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit dhe kreditorit të paraqitur në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore,

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm-fatura mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e së cilës Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbartuesit Privat duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.1039/22, datë 27.07.2023

Gjyqtar

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.